



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 123/4 prot.

Tiranë, më 28.01.2026

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 28.01.2026

PËR KONTROLLUESIN
SHOQATA “QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shoqata “Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin” (në vijim, “Kontrolluesi ose Shoqata”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 266, datë 03.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në regjistrin e OJF-ve, me Vendimin nr. 8351, datë 15.10.1996, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjithë subjektet e ligjit, të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

Shoqata, në cilësinë e kontrolluesit, ka si objekt të veprimtarisë së saj, përmirësimin e politikave dhe legjislacionit të të drejtave themelore të njeriut në fushën e popullsisë dhe shëndetit riprodhues, promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit, si dhe sigurimin e aksesit në informacion dhe shërbime cilësore për të rinjtë dhe grupet në nevojë.

2. Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë dhe përmbushjes së detyrave ligjore të tij, përpunon të dhëna personale për personat “përfitues”, sipas kategorive: “Emër”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, “Nr telefoni”, “Email”, si dhe të dhëna sensitive, si: “Gjendja Shëndetësore”.

Shoqata përpunon të dhëna personale në mënyrë manuale dhe elektronike. Për kategorinë e subjekteve të të dhënave “përfitues”, përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale, të administruara në një regjistër të krijuar posaçërisht për këtë qëllim.

3. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, librin e politikave të punës së shoqatës “Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillim” dhe një model dokumenti lidhur me asgjësimin e dokumentacionit, të titulluar “Procedura e asgjësimit të dokumentacionit përtej afatit”.

Nga analizimi i përmbajtjes së librit të politikave të punës, konstatohet se në të, parashikohen rregulla të përgjithshme dhe jo specifike mbi kategoritë dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet, masat teknike e organizative për administrimin dhe sigurinë e përpunimit të tyre, etj., jo sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 6, të nenit 6 dhe nenit 28 të Ligjit. Në mënyrë të veçantë, vërehet se në këtë rregullore mungojnë parashikime mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, si mënyra e mbledhjes, regjistrimit dhe ruajtjes së tyre.

Mungesa e përcaktimeve të qarta të rregullave të mësipërme është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit. Këto dispozita ligjore kërkojnë që çdo Kontrollues të përcaktojë dhe zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, të cilat garantojnë përpunimin e të dhënave personale në mënyrë të sigurt dhe sipas parimeve të Ligjit, duke ruajtur integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e tyre.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të garantojë mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nga Shoqata, në përputhje me nenet 6 dhe 28 të Ligjit.

4. Gjithashtu, konstatohet se, Kontrolluesi nuk disponon rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen

rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale dhe sensitive, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Gjatë verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kontrolluesi, u konstatua se ky i fundit përpunon edhe të dhëna sensitive të subjekteve përfituese.

Të dhënat sensitive të administruara, të tilla si *“Gjendja Shëndetësore”*, konsiderohen një kategori e veçantë e të dhënave personale, të cilave duhet t’i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar sigurinë e përpunimit të tyre, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 30.04.2025 të Komisionerit *“Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 2”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën duhet të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të parashikojë rregulla të veçanta për këtë kategori të të dhënave personale në rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 2 të Komisionerit.

5. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe publikuar *“Politikat e Privatësisë”* në faqen zyrtare të internetit <https://acpd.org.al/>, duke mos përmbushur kështu detyrimin ligjor për të garantuar transparencën dhe informimin e subjekteve të të dhënave, të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në të.

Mospërbushja e këtij detyrimi nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Ligjit, i cili përcakton se çdo subjekt i të dhënave duhet të informohet në mënyrë të qartë dhe të plotë për qëllimin e mbledhjes dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave të tij personale, kategoritë e të dhënave personale, personat që do t'i përpunojnë apo përfitojnë akses në këto të dhëna, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe për të drejtat që ai gëzon sipas legjislacionit përkatës, përfshirë të drejtën për akses, korrigjim, kundërshtim dhe fshirje të të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet dhe garantohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave që kryen Kontrolluesi.

6. Gjithashtu, konstatohet se nga ana e Kontrolluesit nuk janë marrë masa për dokumentimin e programeve të trajnimit, në përputhje me gerrat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit, i cili nënkupton se nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe punonjësit të cilët gjatë veprimtarisë së tyre përpunojnë të dhëna personale duhet të jenë të trajnuar dhe të ndërgjegjësuar lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në gerrat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të pjesëmarrjes dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara për punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore të datës 21.01.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës deklaruan se kanë marrë dijeni lidhur me gjetjet e procesverbalit të hetimit administrativ, si dhe kanë depozituar pretendimet e tyre me shkrim, përmes shkresës nr. 2 prot., datë 14.01.2026, administruar me tonën me nr. 123/3 prot., datë 20.01.2026, duke paraqitur edhe dokumentacion shtesë për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Më konkretisht:

- Lidhur me specifikimin e rregullave të përpunimit dhe sigurisë së të dhënave personale të përpunuara gjatë veprimtarisë, si dhe hartimit të rregullores në të cilën të parashikohen rregulla konkrete edhe për përpunimin e ligjshëm të të dhënave sensitive, Kontrolluesi ka shprehur gatishmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm për rishikimin dhe hartimin e dokumentacionit, sipas konstatimeve të grupit të hetimit administrativ. Gjithashtu, Kontrolluesi ka bashkëlidhur në cilësinë e provës, Paketën e Anekseve, pjesë e Librit të Politikave dhe Procedurave, ku ka rishikuar dhe përcaktuar kategoritë e të dhënave personale, mënyrën dhe qëllimin e përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Në pretendimet me shkrim, rezulton se, Kontrolluesi pranon gjetjet e grupit të hetimit administrativ lidhur me hartimin dhe publikimin e politikave të privatësisë, si dhe për zhvillimin e trajnimeve në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Lidhur me përcaktimin e afateve të ruajtjes dhe procedurave të asgjësimit, rezulton se Kontrolluesi ka miratuar afatet e ruajtjes për çdo kategori të dhënash personale, si dhe ka bashkëlidhur formularë të asgjësimit të dokumentacionit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 9, 13, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://acpd.org.al/>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;

3. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në gjerat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit, lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre.
4. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 2 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 1 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
6. Komisioneri, bazuar në gjerën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 28.01.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi